

Konsultimet nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së

Serbi, Beograd, Hotel M
24. prill 2010.

Konsultimet i organizoi Fondi për të Drejtën Humanitare. Në takim morën pjesë 54 pjesëmarrës/e, përfaqësues të shoqatave të familjeve të të vrarëve, të zhdukurve, shoqatave të viktimave, veteranëve të luftës, refugjatëve dhe personave të zhvendosur. Mysafirë në këtë takim ishin avokatët kroat nga Osijeku – Miroslav Varga dhe Zhelan Mrak. Fjalën hyrëse dhe moderimin e bëri Natasha Kandiç, anëtare e Këshillit Koordinues të Koalicionit për KOMRA-në (Fondi për të Drejtën Humanitare), ndërsa Marko Veličković nga Qendra për zhvillime të resurseve civile, foli për temën *Pse KOMRA*.

Vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve/eve:

Duhet të zhvarrosen (eskhumohen) edhe viktimat e Luftës së Dytë Botërore. Zhvarrosja e tyre duhet të bëhet në prezencën e përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare.

Është propozuar që të zhvarrosen të gjitha viktimat nga Lufta e Dytë Botërore, dhe natyrisht edhe viktimat e kësaj lufte (...) Të kërkohet nga të gjitha shtetet që viktimat të zhvarrosen (eskhumohen) në shpenzimet e atyre shteteve ku gjenden viktimat, aty ku gjenden mbetjet mortore, në praninë e bashkësisë ndërkombëtare, që të mos shtrembërohen rezultatet, sepse nuk besoj në dinjitetin dhe ndershmërinë e disa republikave në fjalë, që do të ofrojnë të dhëna të besueshme. (Dane Shkoriq, Shoqata Anëtare e Llapqanëve në Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Në Kroaci nuk zbatohet procedura e amnestimit.

(viti 1991) kam qenë komandant i Kazermës në Slavonski Brod. Kazerma ishte sulmuar (...) dhe ne përfundam në burg në Sllavonska Pozhegë. Gjatë tre muajve, atje kemi përjetuar të gjitha torturat e mundshme dhe pastaj me datën 10.12.1991, v, jemi shkëmbyer, ku më është dorëzuar padia ime (...) në vitin '93 në Gjykatën e Qarkut në Sllavonska Pozhegë jam gjykuar dhe dënuar me 15 vite burgim (...) dhe për këtë arsye unë gjendem në listën e Interpolit që nga viti '91, dhe jetoj si në kafaz politik në territorin e Republikës Srpska, dhe nuk kam liri të lëvizjes (...) sipas këtij ligji të ri vetëm katër persona janë abonuar në Kroaci, e kjo i bie 0,004 për qind në

krahasim me numrin e personave sa ka. (Janko Radmanoviq, Shoqata e personave të zhvendosur dhe akuzuar nga viti 1991, Rajon, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Është obligim i gjeneratës sime të evidentojë secilën viktimë dhe të gjitha të këqijat që kanë ndodhë në kohën time.

(...) mendoj se është obligim i gjeneratës sime, dhe i imi, që kam marrë pjesë në te, që ta mbështesë formimin e një Komisioni Rajonal i cili do ta hulumtojë secilin krim, të evidentojë secilën viktimë, dhe të shkruajë për të gjitha të këqijat që kanë ndodhë në kohën time. Dhe kjo është përgjegjësia ime, kjo është ajo çka dua unë, dhe pse jam (...) anëtarë i Koalicionit për KOMRA-në. Mendoj se kjo është e rëndësishme, se ky është kontributi i gjeneratës sime për ata të cilët do të vinë pas nesh. (Miroslav Varga, avokat kroat nga Osijeku, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Veteranët deri më tani askush nuk i ka pyetur për ngjarjet e luftës.

(...) procesi i cili deri vonë më zemëronte shumë, ndërsa tani më pak po më zemëron, ajo është se çdo gjë që ka ndodhë gjatë luftës është thënë nga pikëpamja e viktimës, nga pikëpamja e politikanëve, nga pikëpamja e politikës ditore, nga pikëpamja e zgjedhjeve, nga shikimi për dëmshpërblime të luftës, popujve të Bashkuar. Të gjithë kishin diçka për të thënë, vetëm veteranët askush nuk i pyeti asgjë. A ju ka pyet juve dikush ndonjë gjë – nuk e di, neve askush asnjëherë nuk na ka pyet asgjë, dhe mendoj se kjo është një iniciativë e mirë, prandaj jam pjesëmarrës këtu, si veteran, sepse unë dua ta them atë që mendoj se dikush është dashur të më pyesë. (Miroslav Varga, avokat kroat nga Osijeku, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Dua që të vërtetohet, se pse u shkatërrua fshati im deri në themel.

Te ne ishin rreth 45 shtëpi, Parenata në Islam Latinski, të rrethuar në të gjitha anët me shtëpi kroate (...) Nuk mund të gjendet më asnjë themel i shtëpive ku kanë qenë. Për tetëmbëdhjetë vite askush nuk u kthye më në fshat, nuk kanë ku të kthehen (...) vetëm dua të di se pse është shkatërruar ai fshat deri në themele, dhe pse janë nxjerrë nga toka themelet. (Milan Parenta, refugjat nga Kroacia, nga komuna Zadër, Shoqata e luftëtarëve të luftës të viteve '90-a, komuna e Kikindës, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Unë mezi kam pritë të shkoj në luftë.

Unë jam i ngritur dhe e kam ditur për Informbyronë, e kam ditë për Jasenovcin, për greminat nëpër Hercegovinë dhe kudo, ashtu jam edukuar. Kur çdo gjë ka filluar, unë mezi prisja të shkoja në luftë. Kam kontakte me luftëtarët kroat dhe me myslimanë nga Bosnja (...) Të gjithë në atë kohë, mezi prisnin të shkonin në luftë. (Aleksandër Dragishiç, Shoqata Republikane e luftëtarëve

të luftës së viteve '90, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Inicativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

KOMRA është e nevojshme që më në fund të ndërpritet cikli i hakmarrjeve.

Duhet të formohet Iniciativa për KOMRA-në në mënyrë që më në fund të ndërpritet cikli i hakmarrjeve, viktimat, përsëritja e rrëfimeve. (Boris Deliq, Shërbimi i refugjatëve për kthim "Urat e Reja", Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Inicativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Qe 11 vite jetoj në qendër kolektive dhe shteti asgjë nuk ndërmerr për të na ndihmuar.

(...) jemi të vendosur në qendër kolektive qe 11 vite dhe shteti asgjë nuk ndërmerr për të na ndihmuar, që të mund të vendoseshim në ndonjë mënyrë në shtëpitë tona dhe të jetojmë si gjithë njerëzit tjerë. Në një dhomë 3 me 3 apo pak më të madhe, jetojmë 5 anëtarë. (Milovan Radenović, refugjatë nga Kosova, nga komuna e Vitisë, Qendra Kolektive "Kopshti i fëmijëve", Bujanovc, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Inicativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Duhet të sillen ligjet në përputhje me të dhënat të cilat i mbledhë KOMRA.

(...) neve na duhen ligjet. Ligjet, dhe duhet që Koalicioni për KOMRA-në të mendojë për këtë, do të thotë, të insistojë që me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare dhe organizatave humanitare të sillen ligjet e duhura, të cilët do të duhej të respektohen sipas të gjitha të dhënave që i ka mbledhë KOMRA. (Slobodan Kikić, Shoqata e luftëtarëve të luftës të viteve '90-a komuna e Kikindës, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Inicativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Nëse e arrijmë drejtësinë për viktimat, do ta eliminojmë mundësinë që të përsëritet diçka e ngjashme.

(...) poqe se do të përcaktohem për punë aktive dhe i mbledhim forcat që të zbulojmë të vërtetën e cila ka ndodhë gjatë luftërave, dhe para së gjithash ta arrijmë drejtësinë për viktimat, atëherë do ta eliminojmë mundësinë që kurrë të mos përsëritet diçka e ngjashme. (Radojica Bunjić, pjesëmarrës në luftë gjatë viteve 1991-1995, refugjat nga Kroacia, nga Komuna Pakrac, aktivist për paqe, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Inicativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Komisioni të fokusohet në dëshmitarët e gjallë dhe në luftërat e fundit.

(...) mandati i komisionit të jetë ajo çka ne mundemi, aty ku ekzistojnë njerëzit e gjallë, dëshmitarët (...) Gjatë Luftës së Dytë Botërore janë vrarë shumë, janë vrarë shumë njerëz të pafajshëm (...) të mos mundohemi të arrijmë diçka që është objektivisht e pamundur, por as mos t'i harrojmë ata. (Dragan Pjevaq, Shoqata e familjeve të të vrarëve dhe të zhdukurve në Krainë dhe Kroaci, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Inicativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Të vërtetohen edhe faktet nga Lufta e Dytë Botërore.

Mendoj se është shumë e rëndësishme të vërtetohen edhe faktet nga Lufta e Dytë Botërore. Sigurisht që ne nuk do të mund të hartojmë ndonjë listë të veçantë të viktimave, por ajo çka është shumë e rëndësishme, është që të vërtetohen lokacionet, e lokacionet dihen. Që me të vërtetë të zhvarrosen (eskumohen) mbetjet mortore të viktimave dhe të varrosen në mënyrë të denjë, edhe pse nuk do të mund të identifikohen emrat e individëve, së paku të shënohen. (Miodrag Linta, Forumi Demokratik Serb, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Le të jemi ndërgjegjja e popujve tonë, ta ruajmë dinjitetin e viktimave dhe tua sigurojmë ardhmërinë atyre që do të vinë.

Me rëndësi është se a duam ne ta bëjmë atë që nuk e kanë bërë shtetet tona, atë që nuk e kanë bërë qeveritë tona, atë që nuk e kanë bërë pushtetarët tonë, atë që Akademitë tona të Shkencave dhe Artit nuk e kanë bërë, etj, atë që nuk e kanë bërë kishat tona, e të gjithë e kanë gojën plot me brengën për popullin e tyre dhe të gjithë kujdesen për interesin e tyre nacional, etj. Pra, le të bëhemi ne ndërgjegjja e popujve tonë, dhe të bashkohemi në këtë bazë, ta ruajmë dinjitetin e viktimave, të atyre që më nuk janë, dhe në të njëjtën kohë t'ua sigurojmë një të ardhme atyre që do të vinë. (Zhelan Mrak, avokat kroat nga Osijeku, Kroaci, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

KOMRA të hulumtojë kush është përgjegjës për mobilizimin e pavullnetshëm.

Unë e kam marrë ftesën. Kam qenë i mobilizuar (...) Më është dashur të shkoj. (...) Unë nuk kam pasë motiv, por është dashur të jem atje dhe të gjuaj në Zhelane, por unë këtë nuk e kam dashtë. (...) A mund ta këtë KOMRA mandatin (kompetencën) që dikush të merret me këtë. Pse e ka bërë atë dikush, dhe kush e ka pasë mandatin (kompetencën) dhe vendimin që të veprohet ashtu. Do të thotë, nuk jemi në luftë, ndërsa unë e kam armën në dorë dhe duhet të shtie. Nëse nuk shtie, do të përballem me pasojat. (Zoran Kosiq, Shoqata e luftëtarëve të luftës të viteve '90-a komuna e Kikindës, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Së pari të hulumtohen shkaqet e luftës.

Prandaj do të propozoja që së pari të nisemi nga fillimi, ti shohim shkaqet. Sepse, mjeku së pari i zbulon shkaqet e sëmundjes, e pastaj fillon ta shërojë atë dhe ia jep ilaçet pacientit. (Dragan Milikoviq, Shoqata e luftëtarëve të luftës të viteve '90-a komuna Lebane, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

A do të duhet komisioni ta hartojë listën e kryesve potencial të krimeve të luftës dhe të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut?

A do të ishte mirë, dhe e dobishme poqë se do të kemi listën e kryesve potencial të krimeve të luftës, por që secilit që do të gjendej në atë listë t'i jepet e drejta për të hedhur poshtë atë akuzë apo për të sjellë fakte që ajo nuk është e vërtetë. Pra, kjo është një pyetje duke pasë parasysh se ka pas komisione të cilat e kanë pasë në mandatin e tyre këtë çështje. (Natasha Kandiq, Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Hartimi i listës së kryesve potencial të krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut do të shkelte prezumimin e pafajësisë.

Unë më me dëshirë do të mbaja prezumimin e pafajësisë. Që, secili është i pafajshëm derisa të dëshmohet fajësia e tij. Nuk është te ai ta vërtetojë (...) Le t'ia vërtetojë atij dikush se është kriminel lufte. (Zhelan Mrak, avokat kroat nga Osijeku, Kroaci, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Mandati i komisionit nuk duhet të jetë shumë i gjerë.

Pra, angazhohem për atë që ai (mandati i komisionit) të mos jetë shumë i gjerë, të reduktohet në vërtetimin, regjistrimin e viktimave, rrethanat nën të cilat janë vrarë, të regjistrohen, shkruhen (...) pasojat drastike të luftës prej shkatërrimeve materiale, përndjekjeve, shkatërrimit të monumenteve kulturore – historike (...) të shikohet çfarë kompensimi tu bëhet viktimave. (Drago Kovačević, Forumi Demokratik Serb, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Përqendrimi në vërtetimin e një liste të veçantë të viktimave, shënimit të kampeve të përqendrimit dhe regjistrin e të burgosurve të kampeve të përqendrimit.

Mendoj se Iniciativa do të përjetonte mos sukses poqë se në mandatin e saj do të ketë çështjen e karakterit të luftës, çështjen e shkaqeve të luftës, çështjen se kush është përgjegjës, a është ajo përgjegjësi e shpërndarë në bazë paritetit apo ndokush ka shkallë më të lartë të përgjegjësisë apo shkallë më të ultë të përgjegjësisë. (...) Vërtetë duhet të koncentrohemi në mandatin primar. Kjo do të thotë, në përpilimin e një liste të veçantë të viktimave, të koncentrohemi në kthimin e dinjitetit të viktimave. Natyrisht, sektori i shoqërisë civile dhe ky koalicion çdo herë mund të insistojë në procedimin e krimeve të luftës si një segment i dytë shumë i rëndësishëm, dhe mendoj se ideja të cilën ju e përmendët është shumë interesante, kjo ka qenë në debatin me të burgosurit e kampeve të përqendrimit që të hartohet një listë e kampeve të përqendrimit dhe të burgosurve të kampeve të përqendrimit. Mendoj se ata janë njerëz atje kanë qenë të nënçmuar, të cilat kanë qenë të maltretuar vetëm për shkak të përkatësisë nacionale dhe fetare të tyre, dhe pas kësaj do të duhej të pasoj një marrëveshje në nivel rajonal gjithashtu lidhur me shënimin e atyre vend ndodhjeve, gjegjësisht të varrezave masive dhe kampeve të përqendrimit ku njerëzit janë maltretuar, torturuar dhe vrarë, dhe mendoj se poqë se komisioni rajonal do të arrinte ti bënte këto dy gjëra, ky do të ishte një kontribut shumë i madh në krijimin e besimit dhe në vijë të fundit të arritjes së pajtimit në territorin e ish Jugosllavisë. (Miodrag Linta, Forumi Demokratik

Serb, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Është e pamundur të vërtetohen shkaqet e luftës.

Ne duhet ta kuptojmë se jemi në këto hapësira, dhe se është e domosdoshme për gjeneratat e ardhshme të vërtetohen faktet. (...) Do të ishte mirë, por mendoj se nuk është e mundur, të vërtetohen shkaqet e luftës. Kjo do të na qonte të diçka tjetër, të cilën ky koalicion nuk do të mund ta realizojë. (Marinko Gjuriq, Shoqata e të kidnapuarve dhe të zhdukurve nga Kosova dhe Metohija, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Të punohet njëjtë si në zbulimin e fakteve të viktimave nga luftërat e fundit, gjithashtu edhe nga Lufta e Dytë Botërore.

KOMRA, le ti bëjë të gjitha (...), pra nuk mundem tani të kaloj nëpër të gjitha të dhënat për viktimat e viteve prej '41 deri '45, dhe them, nuk janë prioritet tani, le të mbesin. Për të mirën e të gjithëve, së pari për të mirën e të vërtetës, mendoj se duhet të punohet njëjtë në të gjitha fushat, gjegjësisht në të gjitha periudhat kohore, nëse duam që të pasojë pajtimi. (Vladica Cvetković, Shoqata e luftëtarëve të luftës të viteve '90-a, komuna Sverlig, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Mandati (kompetenca) e komisionit është ti vërtetojë faktet, e jo ti interpretojë ato.

Mua e vërteta nuk më intereson aq shumë. Unë e kam të vërtetën time. Mua më interesojnë faktet. Unë dua të di sa njerëz janë përndjekë nga Lapca, sa njerëz është deshtë të largohen nga Pakraci, nga Glina, nga Gazivoda, dua ta di këtë, sepse tani këtë nuk e di. Mua më interesojnë faktet. Mandati (kompetenca) e komisionit është ti vërtetojë faktet, mandati i komisionit është të mos i interpretojë ato, të mos i formësojë (...) Detyra e komisionit, në fakt, është të vërtetojë se në ditën e caktuar, datën dhe vendin e caktuar ka vdekur personi i caktuar, është përndjekë me dhunë, përdhunuar apo vranë, apo çkado tjetër që nuk është dashtë të ndodhë. (Miroslav Varga, avokat kroat nga Osijeku, Kroaci, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Komisioni duhet të përbëhet nga dy anëtarë nga secili Parlament – njëri nga partia në pozitë dhe tjetri nga partia në opozitë. Veteranët duhet të kenë një këshill të veçantë në këshill.

(...) [komisioni] duhet të jetë rajonal, dhe pa vendim politik dhe vullnetin politik të të gjitha shteteve nuk do të formohet. Prandaj, mendoj se këtu duhet të marrë pjesë politika. Sipas meje, do të ishte më së miri (...) që komisioni të formohet me nga dy anëtarë nga secili Parlament. Njëri nga partia në pozitë dhe tjetri nga partia në opozitë, dhe kjo nga secili shtet (...) ndërsa nëpër këshille, nënkomisione dhe trupat punues (...) një këshill e meritojnë edhe veteranët që të kenë mundësinë dhe të drejtën ti paraqesin pikëpamjet e tyre, ngjarjet e tyre, dëshmitë e tyre nëse i ka dikush. Sepse, sot ka njerëz që nuk flasin, por ndoshta kur dikush të vdesë, pastaj mund të

flasin, sepse frika do të zhduket. (Miroslav Varga, avokat kroat nga Osijeku, Kroaci, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Publikimi i fakteve të vërtetuara është thelbësore për t'iu shmangur interpretimeve të ndryshme.

Gjithsesi mendoj se është i rëndësishëm dëgjimi publik i viktimave dhe njëri ndër (...) detyrat më të rëndësishme të komisionit rajonal e cila do të vërtetonte faktet është regjistrimi i fakteve dhe publikimi i tyre. Në cilëndo formë, në internet, në formë dokumenti, broshure, sidoqoftë, por gjithsesi në ndonjë formë e cila do të jetë në dispozicion për secilin që është i interesuar ta di. Atëherë do ti shmangim të gjitha ato situata të pakëndshme rreth interpretimeve të ndryshme të të vërtetave të tyre, fajësisë së njërit apo tjetrit. (Miroslav Varga, avokat kroat nga Osijeku, Kroaci, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).

Veteranët e luftës duhet ti emërojnë përgjegjësit e krimeve të luftës.

(...) mendoj se roli ynë si veteranë të luftës në këtë proces, (...) dhe besoj se (...) kemi pasë rast të shohim gjëra të ndryshme, se nuk frikësohemi të tregojmë çka kemi parë dhe në këtë mënyrë t'i emërojmë (...) përgjegjësit për krimet e luftës. (Radojica Bunqiq, pjesëtar i luftës prej 1991-1995, refugjat nga Kroacia, nga komuna Pakrac, aktivist për paqe, Beograd, Serbi, Konsultimet Nacionale me veteranët, refugjatët dhe personat e zhvendosur mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Beograd, 24 prill 2010).